



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 1023/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkritazi me apelin e Enver Bajrami, kandidat për anëtar të Kuvendit Viti, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Viti, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Enver Bajrami, kandidat për anëtar të Kuvendit Viti, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Viti, me shenjë ZL.Anr.1023/2017, të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunale të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar me postë apelin ZL.Anr.1023/2017 me datën 10.11.2017, nga Enver Bajrami, kandidat për anëtar të Kuvendit Viti, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Viti, me të cilën pretendon se nuk janë numëruar në mënyrë të sakt votat në vendvotimet: 2611d/01R, 2611d/02D, 2630d/01R, 2630d/02D, 2610d/02D, 2610d/01R.

Në mbështetje të pretendimeve apeli i ka bashkangjitur kopjet e Formularëve të Rezultatëve për Kandidat.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se parashtruesi në apel me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar pretendimet e tij. Prandaj, Paneli apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL.Anr.1023/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*